



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.993/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “N.T.SH” DINO SH.P.K., me NUI: 811272343, me adresë Konjuh-Lipjan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.S. jurist dhe M.B., që të dy nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson Fatime Mustafa, avokate publike komunale, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin përmbartimor P.nr.250/2021 të datës 15.09.2021, të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datën 18.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Lipjanit, Urdhri Përmbartimor P.nr.250/2021 i datës 15.09.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “N.T.SH” DINO SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.250/2021 të datës 15.09.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit - Faturës Nr. 2840/21 të datës 01.09.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 20,217.64 €, me kamatëvonesë prej 8%, shpenzimet e përmbartimit dhe tarifën e efikasitetit për vlerën e përmbartuar, aq sa do bëhen sipas listës së shpenzimeve sipas udhëzimit administrativ 06/14 të Ministrisë së Drejtësisë, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit ligjor, ka deklaruar ndër të tjera se përmbartuesi privat gjatë shqyrtimit të lëndës ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase fatura nuk e ka vulën e protokolluar siç parashihet me Ligjin mbi Arkivat, e që nga kjo arsye i mungon numri dhe data e pranimit e në fakt nga kjo rezulton se fatura nuk është pranuar dhe dorëzuar te organi kompetent. Debitori ka shtuar se

Përmbareuesi Privat ka bërë shkelje të dispozitave materiale të LPP-së, ku në mënyrë të qartë shihet se dokumenti nuk e ka titullin e dokumentit autentik-të besueshëm ashtu siç parashihet me ligj, dhe se fatura e prezantuar nga kreditori nuk është origjinale e as e vërtetuar sipas ligjit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri urdhri përmbareimor.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit në prapësim, duke theksuar ndër të tjerash se ofron dëshmi se fatura është pranuar nga debitori, ndërsa pretendimet e debitorit se dokumentit përmbareues nuk i janë bashkëngjitur dëshmitë e duhura nuk qëndrojnë ngase në shkresat e lëndës shihet se fatura e përmendur në propozim për përmbareim është në origjinal. Gjithashtu, kreditori ka theksuar se fatura në rastin konkret i përmbush kushtet si dokument i besueshëm dhe se obligimi në të është pranuar si obligim nga ana e debitorit, prandaj nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se borxhi nuk është i bazuar në ndonjë punë të vlefshme juridike dhe se ky obligim nuk i takon debitorit. I ka propozuar gjykatës që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, dhe ta vërtetojë urdhrin përmbareimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbareimore, (në tekstin e mëtejme: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbareimor duhet të shfuqizohet, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr.2840/21 të datës 01.09.2021, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbareim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbareimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbareim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbareim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas

nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura Nr. 2840/21 të datës 01.09.2021, bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori, pasi që e njëjta nuk është protokolluar në zyrën e pranimit të debitorit – Komuna e Lipjanit dhe nuk përmban vulën e pranimit – protokollimit me të cilën do të dëshmohej se fatura është pranuar me rregull nga ana e debitorit, andaj rezulton se si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbartim.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.993/22, datë 18.10.2023

Gjyqtari

Gent Beker

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.